



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M Nr. 5, datë 20.12.2018

MBI CAKTIMIN ME SHORT TË MANDATIT 3-VJEÇAR TË ANËTARËVE GJYQTARË DHE ANËTARËVE JOGJYQTARË (konsoliduar me vendimin e KLGJ-së nr. 448, datë 15.10.2020)

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur për herë të parë, sot më datë 20.12.2018, me pjesëmarrjen e 11 anëtarëve, mbështetur në nenin 179, pika 5 e Kushtetutës së Republikës, në nenin 276, pika 7 e Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas realizimit të procedurës me short sipas rregullave bashkëlidhur këtij vendimi,

V E N D O S I:

- I. Anëtarët gjyqtarë, të cilët do të shërbejnë për një mandat trevjeçar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë:
 1. Z. Medi Bici, nga Gjykata e Lartë;
 2. Z. Ilir Toska, nga gjykatat e apelit;
 3. Znj. Brunilda Kadi, nga gjykatat e shkallës së parë.

- II. Anëtarët jogjyqtarë, të cilët do të shërbejnë për një mandat trevjeçar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë:
 1. Z. Erjon Muharremaj, nga trupa e pedagogëve;
 2. Z. Maksim Qoku, nga trupa e pedagogëve.

- III. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që shërbejnë me mandat tre vjeçar ka filluar në datën 12.12.2018 dhe përfundon në datën 12.12.2021.

- IV. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që shërbejnë me mandat pesë vjeçar ka filluar në datën 12.12.2018 dhe përfundon në datën 12.12.2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR